



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOFIKA K. BRAKA
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.11, NR.1, NR.1
TEL: 684066835

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 164

Nr. koleksioni: 122

Tirane më 18/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052850012467891

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 164 Rep.

Nr. 122 Kol.

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë, në datën 18/02/2021 (dymijë e njëzetë e një), unë notere Sofika K. Braka, me zyrë në rrugën "Ismail Qemali", pallati 11/1, me kërkesën e palëve të poshtëshënuara, redaktoj këtë kontratë dhurimi kuotash të kapitalit të shoqërisë:

Dhuruesi:

znj. **Edlira Podgorica (Fino)**, atesia: Gezim, e datëlindjes 29.05.1988, lindur në Shkoder dhe banuese në Tiranë, Rruga "Sami Frasheri", Nr. 56, Kompleksi TID, Njesia Administrative Nr. 5, Shkalla B, Ap 4/1, identifikuar me pasaporten nr. BJ0108478 dhe nr. Personal: I85529081U, madhore me zotësi të plotë për të vepruar;

PRANUESI I DHURIMIT:

z. **Rejdi Fino**, atesia: Bashkim, i datëlindjes 15.04.1989, lindur në Librazhd e banues në Tiranë, Rruga "Sami Frasheri", Nr. 56, Kompleksi TID, Njesia Administrative Nr. 5, Shkalla B, Ap 4/1, identifikuar me pasaporten nr. BB4884053 dhe nr. Personal: I90415080W, madhor me zotësi të plotë për të vepruar,

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

NENI 1

Dhuruesi është ortak me 30% të kuotave të shoqërisë "Fino" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 12.09.2018, me NUIS: L82112037C, me seli në Rr. "Siri Kodra", Magazina nr. 5, Tiranë. Kjo shoqëri e ka kapitalin e saj 100 000 Lekë, nga të cilat: Vlera e kapitalit të Dhuruesit është 30 000 Leke. Këto kuota sipas ekstraktit të shoqërisë, janë të lira për tu transferuar.

NENI 2

Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhurimi dhe pranimi i dhurimit të 30 % të kuotave të kapitali të shoqërisë "Fino" Sh.p.k., që zotërohen nga Dhuruesja znj. Edlira Podgorica (Fino), tek Pranuesi i Dhurimit z. Rejdi Fino.

Edlira Podgorica Fino

1

NENI 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e Dhuruesit

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi heq dorë nga pronësia e 30% të kuotave të shoqërisë "Fino" Sh.p.k., pa asnjë kusht.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Dhuruesi zhvishet nga pronësia e kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k, në masën 30% të tyre.
- 3.3 Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit se kuotat e kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k, që ajo zoteron, në masën 30% të tyre, janë të lira nga çdo barrë apo detyrim mbi to dhe janë lirisht të transferueshme sipas ligjit.
- 3.4 Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit nga çdo pretendim i të tretëve lidhur me pronësinë e 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k., të zotëruara prej saj.

NENI 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Pranuesit të Dhurimit

- 4.1 Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i dhurimit pranon të ketë në pronësi të tij (30% të dhuruara + 70% që i zoteron vetë) 100 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k.
- 4.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate Pranuesi i Dhurimit behet pronar i 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k.
- 4.3 Për çdo pretendim që mund të lindë nga personat e tretë lidhur me pronësinë e 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Fino" Sh.p.k, Pranuesi i Dhurimit është i detyruar të njoftojë Dhuruesin, ku ky i fundit do të jetë përgjegjës personalisht ndaj pretendimit që mund të kenë të tretet në lidhje me këto kuota.

NENI 5

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

"Une noterja mora autorizimin për përdorimin e të dhenave personale të paleve dhe të dhenat e përdorura në këtë dokument, të cilat do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin dhe redaktimin e këtij akti. Përpunimi i dhenave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe rigoroz të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, "Për mbrojtjen e të dhenave personale".

Gollire Podgori of Fino



Kontrata hartohet në katër kopje me nga tre fletë, me të njejtën vlerë ligjore. Une noterja, pasi iu bëra me dijeni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë dhurimi që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj sipas ligjit.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018, date 20.12.2018, "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

PALET KONTRAKTORE

DHURUESI
EDLIRA PODGORICA (FINO)

PRANUESI I DHURIMIT
REJDI FINO

Edlira Podgorica Fino

Rejdi Fino



NOTERE
Sofika K. BRAKA

